Ambasadori Reeker viziton Maqedoninë

Zëvendës ndihmës sekretari i shtetit për Evropë dhe Euroazi dhe ish ambasador në Republikën e Maqedonisë Philip Reeker qëndroi në Maqedoni nga 15-18 qershor si pjesë e vizitës së tij të rregullt në rajon, si dhe për të marrë pjesë në konferencën e Adriatikut 5 (A5) që u mbajt më 18 qershor. Ai realizoi takime me presidentin Ivanov, kryeministrin Gruevski, zëvendës kryeministrin për çështje evropiane Fatmir Besimi, dhe kryetarin e LSDM-së Zoran Zaev, si dhe me liderë afaristë, qeveritarë dhe të komuniteteve. Ambasadori Reeker gjithashtu morri pjesë në lojën e hendbollit mes Maqedonisë dhe Portugalisë dhe ishte i kënaqur që Maqedonia korri fitore, gjë që e kualifikon atë për pjesëmarrje në Kampionatin Evropian.